



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/23


Datë: 15.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Veprimtarinë Hidrometeorologjike.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja-Ministry of Environment and Spatial
Planning*

KONCEPT DOKUMENTI PËR VEPRIMTARITË HIDROMETEROLOGJIKE

Hyrje

Gjatë zbatimit të Ligjit me Nr.02/L79 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike janë vërejtur zbrazëtira ligjore në harmonizimin e mënyrës së informimit të publikut dhe procedurës së ofrimit të shërbimeve për palët e interesuara dhe për personat fizik.

Me qëllim të administrimit të mirë të veprimtarisë hidrometeorologjike të Kosovës, si dhe definimin e kësaj veprimtarie, harmonizimin e politikave dhe standardeve me Organizatën Botërore Meteorologjike (OBM) dhe të Bashkimit Evropian (BE) duhet të hartohet ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike.

Në Programin legjislativ për vitin 2014 është planifikuar hartimi i Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike.

Koncept dokumenti për hartimin e Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike, përmban opsionet për zgjidhjen e problemeve dhe administrimin më të mirë të veprimtarive hidrometeorologjike duke përfshirë administrimin e ndikimit të dukurive hidrologjike dhe meteorologjike në mjedis, mirëqenien e njeriut dhe në pronat e tyre si dhe ndikimi ekonomik dhe social në vend.

1. Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor:

1. Rregullimi i çështjes për veprimtaritë hidrometeorologjike, ka për qëllim të administrojë mirë veprimtaritë hidrometeorologjike të Kosovës, si dhe definimin e kësaj veprimtarie, harmonizimin e politikave dhe standardeve me Organizatën Botërore Meteorologjike (OBM) dhe të Bashkimit Evropian (BE).

Çështja e Veprimtarive Hidrometeorologjike deri diku është e rregulluar me ligjin aktual për Veprimtaritë Hidrometeorologjike Nr.02/L-79, mirëpo gjatë zbatimit të këtij Ligji janë identifikuar mangësi në mënyrën e informimit të publikut dhe procedurës së ofrimit të shërbimeve për institucionet, palët e interesuara dhe për personat fizik.

Gjithashtu është identifikuar mospërfshirja e disa përkufizimeve të nevojshme, dispozitave që rregullojnë dhe përcaktojnë qartë veprimtaritë hidrometeorologjike.

Ligji ekzistues ka paqartësi të cilat paraqesin problem në definimin e qartë të:

1. Përgjegjësi dhe aktivitetet e IHMK-së;
2. Mënyrës së informimit dhe raportimit për të dhënat hidrometeorologjike, të cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut;
3. Mënyrës së paralajmërimit të fatkeqësive natyrore që shkaktohen nga kushtet meteorologjike, hidrologjike dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut;
4. Harmonizimit të standardeve me Bashkimin Evropian (BE) dhe Organizatën Botërore Meteorologjike (OBM).

2. *Veprimtaria hidrometeorologjike dhe ndikimet e saj*

Veprimtaritë hidrometeorologjike janë aktivitete me rëndësi për Republikën e Kosovës në lidhje me mbrojtjen e jetës dhe pasurisë së njeriut nga ndikimet e fatkeqësive dhe katastrofave natyrore të ndikuara nga dukuritë meteorologjike dhe hidrologjike, si dhe përdorimi racional i kushteve të motit, klimës dhe resurseve ujore, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Kosovës. Është veprimtari e rëndësishme e cila ka ndikim në mjedis, mirëqenien e njeriut dhe në ekonominë e një shteti.

Veprimtaria hidrologjike dhe meteorologjike ka ndikim edhe në planifikimet e tona ditore dhe afatgjata, sado që këto dukuri parashikohen dhe monitorohen, në shumë raste natyra din të bëjë befasi të saja duke shkaktuar fatkeqësi natyrore, por me zhvillimin e kësaj veprimtarie është arritur që të adaptohem të jetojmë nën presionin e këtyre dukurive si dhe që fatkeqësitë natyrore të tejkalohen me më pak dëme materiale dhe civile.

Me administrimin e mirë të veprimtarisë hidrologjike dhe meteorologjike arrihet menagjimi dhe parandalimi i rreziqeve nga dukuritë hidrologjike dhe meteorologjike, siç janë: vërshimet, thatësitat, djegia e pyjeve etj.

Që të arrihet menagjim i mirë i veprimtarive hidrologjike dhe meteorologjike në rend të parë duhet të:

- Ngritet rrjeti i monitorimit të parametrave dhe dukurive meteorologjike;
- Ngritet rrjeti hidrometrik i monitorimit të rrjedhave të lumenjeve dhe niveli i tyre
- Ngritja e sistemit të paralajmërimit të hershëm të rreziqeve dhe
- Ngritja e sistemit informativ dhe informimi i opinionit dhe institucioneve përgjegjëse për menagjim të emergjencave.

Marrja e informatave mbi kushtet hidrologjike, meteorologjike dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës është e rëndësishme edhe në planifikimin hapësinor të zonave të banimit. Vlerësimi i drejtë i këtyre informacioneve rezulton në planifikim të qëndrueshëm si në aspektin ekonomik dhe atë social.

Ndikimi në mjedis- Dukurit hidrologjike dhe meteorologjike mund të ketë ndikim pozitiv por edhe negativ në mjedis. Ndikimi pozitiv konsiderohet kur në ato zona mbretërojnë kushtet e mira meteorologjike dhe hidrologjike, në atë raste e ndihmon zhvillimin e bujqësisë dhe pasurohet ekosistemi. Ndërsa ndikimi negativ paraqitet në zonat në të cilat janë të ndikuara nga dominimi i kushteve të këqija të motit, siç janë: mungesa e reshjeve (thatësitrat), reshjet e shumta të borës dhe shiut (vërshimet dhe orteqet).

Vërshimet dhe thatësitrat që të dy kanë ndikime negative në mjedis, duke shkaktuar humbje materiale, sociale por edhe dëme në ekosistem.

Ndikimet negative të kushteve atmosferike në mjedisë do të zvogëlohen përmes aplikimit të Veprimtarive hidrometeorologjike që d.m.th. se me monitorimin e dukurive hidrologjike dhe meteorologjike do të menagjihen rreziqet natyrore duke ndermarrë masa mbrojtëse dhe aktivitetet për tejkalim të rrezikut.

Në rastë se nuk do të aplikohen veprimtarit hidrometeorologjike mundësia e menagjimit të rreziqeve nga dukuritë natyrore është më e vogël dhe ndërmarra e aktiviteteve për tejkalim ta gjendjes së rrezikut do të jetë jo efikase.

Ndikimi në shëndet- Efektet në shëndet nga dukuritë hidrologjike dhe meteorologjike janë të lidhura në mënyrë indirekte, pasi që në kushtet meteorologjike ndikojnë në zhvillimin e shumë insekteve të cilat janë bartëse të shumë sëmundjeve të ndryshme të cilat mund të kalojnë në epidemi. Poashtu bashkë me lëvizjet e ajrit (erërat) barten viruse të ndryshëm nga një vende në vendin tjetër.

Në shumicën e rasteve, efektet nga kushtet meteorologjike dhe hidrologjike janë të vogla, në disa raste ndikimi mund të jetë i madh, dhe në raste ekstreme, kërcënues për jetën.

Me hartimin e këtijë ligji do të arrihet që të informohen institucionet përgjegjëse për menagjimin e rasteve emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e natyres si :vërshimet, thatësitrat dhe djegëja e pyeve, në mënyrë që të ndërmerren masa për tejkalimin e rreziqeve me sa më pakë dëme në njerës dhe në prona.

Dëmtimi i pronës- Në shumë raste kushtet meteorologjike ndërlidhen me ndotjen e ajrit dhe në këtë rastë shkaktjnë shqetësim për shoqëri sepse shkaktohen shirat acidike të cilat ndikojnë në dëmtimin e pronës, veçanarisht monumenteve kulturore dhe historike, por edhe të dëmtimit të pronave private. Poashtu në rastin e vërshimeve të shkaktuara si rezultat i reshjeve të shumta vije deri te dëmtimi i pronave.

Ndikimi në ekonomi- mund të jetë ndjerë në shumë zona dhe është shpesh një rezultat i ndikimeve të lartëpërmendura. Disa nga efektet që mund të identifikohen përfshijnë:

- Zvogëlimin e vlerave të pronës;
- Pengesë për zhvillimin e vendbanimeve të reja;

-Humbje e potencialit të turizmit, zhvillimit të bujqësisë etj.

Gjendja aktuale dhe politikat

Sistemi aktual institucional mbi veprimtarite Hidrologjike është zhvilluar nga fundi i vitit 2002. Në parim, përbëhet nga një sistem menaxhimi institucional i shpërndarë.

Instituti hidrometeorologjik si institucion për menaxhim të veprimtarive hidrometeorologjike zhvillon veprimtarinë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi, të R. së Kosovës dhe standardeve të OBM dhe të BE.

Sistemi për administrimin e veprimtarive hidrometeorologjike:

- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Ministria) – organi i lartë ekzekutiv mbi territorin e Kosovës që krijon dhe zbaton politikën kombëtare mjedisore dhe koordinimin me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare mjedisore;
- Agjencionin për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës- Zhvillon monitorimin, raportimin dhe vlersimin e gjendjes mjedisore në Kosovë.
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës- Institucion monitorues për monitorimin e elementeve dhe dukurive hidrologjike, meteorologjike dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës.
- Komuna – organ ekzekutiv mbi territorin e komunës, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit dhe planeve komunale mjedisore.

Ligjet dhe Aktet nënligjore

Ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me çështjen e veprimtarive hidrometeorologjike janë:

1. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025,
2. Ligji i ujrave, Nr.04/ L-147
3. Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, L-012-2010
4. Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Nr. 04/ -L-027
5. Rregullore qrk - për organizimin dhe operimin e sistemit të monitorimit, njoftimit dhe paralajmërimit, Nr. 18/2013
6. U.A. Nr. 15/2010 për Kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshtësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të dhënave

Gjatë zbatimit të ligjeve të lartpërmendura nuk është vërejtur ndonjë konflikt mes këtyre ligjeve dhe Ligjit për Veprimtarit Hidrometeorologjike, përkundrazi ato e mbështesin njëri-tjetrin në favor të administrimit më të mirë të veprimtarive hidrometeorologjike. Mirëpo në ligjin aktual mbi Veprimtaritë Hidrometeorologjike janë vërejtë mangësi të cilat paraqesin probleme në efikasitetin e zhvillimit të aktiviteteve të duhura në rastet të caktuara. Mungesa e një neni të caktuar në ligjin

aktual i cili obligon nxjerrjen e një udhëzimi administrativ që rregullonë procedurat standarde operative mbi shkëmbimin e informacioneve në mesë të institucioneve që janë të ndërlidhura me veprimtaritë hidrometeorologjike.

Programi aktual

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si organ i Qeverisë së Republikës së Kosovës hartone Strategjiutë për mbrojtjen e mjedisit, duke u siguruar se të gjitha institucionet tjera dhe komuniteti i gjerë, janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të tyre për arritjen mbrojtjes së mjedisit dhe resurseve natyrore.

2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si organ i Qeverisë së Republikës së Kosovës është përgjegjëse për hartimin e Programit për Monitorimin e Ujrave, dukurive meteorologjike, cilësisë së ajrit dhe dheut duke u siguruar se të gjitha institucionet tjera dhe komuniteti i gjerë janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të tyre për arritjen e monitorimit të dukurive të lartepërmendura dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut.

3. Në bazë të Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025, Ligjit të ujrave, Nr.04/ L-147, Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe ligjit aktual mbi veprimtaritë Hidrometeorologjike, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës është i obliguar të bëjë monitorimin e dukurive dhe elementeve hidrometeorologjike si dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut.

4. Instituti hidrometeorologjikë është i obliguar që ti ofrojë informacionet mbi parashikimin e rrezikut nga fatkeqësit natyrore të gjitha institucioneve qe ndërlidhet veprimtaria e tyre me veprimtarin e IHMK siq është Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Agjensioni për Menagjimin e Emergjencave, si dhe Departamenteve dhe Inspektoriatit të MMPH.

Shpenzimet aktuale

Te bashkengjitur me koncept dokumentin jane tabelat ne excel ku eshte dhene kostoja vjetore e shërbimeve, për zbatimin e ligjit

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Ligjit aktual i mungojnë disa nene të cilat obligojnë nxjerrjen e akteve nënligjore që krijojnë lehtësira në implementimin e ligjit. Për faktin se në Ligjin ekzistues mungojnë disa akte nënligjore përmes të cilave rregullohet qartë veprimtaria e IHMK-së propozohet që të hartohet Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike. Këtij ligji i mungojn aktet nënligjore që rregullojnë procedurat standarde operative të mënyrës së

informimit të institucioneve dhe akti nënligjorë që rregullonë qmimet e shërbimeve të IHMK ndaj palëve të interesuara dhe institucioneve.

Projektligji do të avansojë sistemin e monitorimit të elementeve dhe dukurive meteorologjike, hidrologjike dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut si dhe sistemin e paralajmërimit të fatkeqësive natyrore siç janë: vërshimet, thatësitat, breshëri, orteqët e borës etj.

Përvojat në shtetet tjera

Shtetet e rajonit kanë kaluar nëpër fazat e tranzicionit ashtu siç po kalon edhe Kosova. Kështu që përvojat në këto shtete, si në zhvillimin e legjislacionit poashtu edhe në zbatimin e tij, nuk dallojnë shumë nga Kosova. Rast konkret kemi Shqipërinë, Kroacinë të cila tani kanë të rregulluar këtë veprimtari, po ashtu rastë tjetër është Maqedonia, Mali i zi, R. Çeke e cila e ka të rregulluar shumë mirë veprimtarin hidrometeorologjike në Institutin Hidrometeorologjik Çekë.

Synimet dhe Objektivat

Synimi i përgjithshëm për rregullimin e çështjes së Veprimtarive Hidrometeorologjike është plotësimi i ligjit aktual me nevojat e lartpërmendura dhe harmonizimin e obligimeve që dalin nga legjislacioni i vendit. Me këtë synohet krijimi i disa akteve nënligjore që lehtësojnë zbatimin e këtij ligji.

Synimet

- Administrimi më i mirë i Veprimtarive Hidrometeorologjike;
- Monitorimin e dukurive hidrologjike, meteorologjike, cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut;
- Marrja e informatave të mjaftueshme për dukuritë hidrologjike, meteorologjike, cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut
- Të sigurojë informatat e mjaftueshme për publikun në lidhje me gjendjen hidrologjike, meteorologjike, cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në Kosovë.
- Të sigurojë paralajmërimin e publikut mbi rreziqet nga fatkeqësitë natyrore, si: vërshimet, thatësitat etj;
- Të sigurojë informimetat për publikun mbi parashikimin e motit;
- Harmonizimi i ligjit aktual me legjislacionin e vendit, rregulloret e OBM dhe standardeve të BE-së për veprimtaritë hidrometeorologjike.

Objektivat

- Avansimi i sistemit të monitorimit dhe paralajmërimit të dukurive dhe elementeve meteorologjike, hidrologjike, cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut;
- Promovimi i rëndësisë së monitorimit të dukurive hidrologjike, meteorologjike cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës;
- Sigurimi i infrastrukturës ligjore për komunikim efikas në mes të institucioneve që ndërlidhen me veprimtarinë hidrometeorologjike

Me arritjen e qëllimeve dhe objektivave do të sigurohet:

- Mbrojtja e mirëqenies së njeriut, pronave, mjedisit dhe ekonomisë së vendit.
- Sigurimi i procedurave operative, për paralajmërimin e hershëm të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore;
- Demonstrimi i gatishmërisë së institucioneve qeveritare dhe atyre lokale në mbrojtjen e popullatës dhe pronave nga fatkeqësitë natyrore që shkaktohen nga dukuritë hidrometeorologjike;
- Identifikimi i zonave dhe çështjeve me fokus special

Hartimi i ligjit me propozimet për zbatim më të lehtë të tij, rezulton në plotësimin e prioritetit të Qeverisë për sundimin e ligjit.

Opsionet

Për të siguruar përfitime të rëndësishme për cilësinë e jetës dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, janë analizuar këto opsione;

- Opsioni i parë- Mosndryshimi i Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
- Opsioni i dytë- Ndryshimi i pjesërishëm i Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
- Opsioni i tretë- Hartimi i ligjit të ri për Veprimtaritë Hidrometeorologjike

Opsioni i parë:

Me mosndryshimin e ligjit, nuk do të përmbushen standardet që dalin nga Organizata Botërore Meteorologjike për veprimtaritë hidrometeorologjike, mospermbushja e obligimeve që dalin nga ligjet aktuale të Republikës së Kosovës dhe vështirësitë në zbatimin e tyre.

Opsioni i dytë:

Plotësimi i pjesërishëm paraqet problem gjatë zbatimit të ligjit dhe kërkon harmonizim të legjislacionit vendor që ndërlidhet me veprimtaritë

hidrometeorologjike.

Opsioni i tretë:

Opsioni i rekomanduar është nxjerrja e Ligjit të ri për Veprimtaritë Hidrometeorologjike.

Hartimi i Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike propozohet, për faktin se në ligjin ekzistues mungojnë disa akte nënligjore përmes të cilave rregullohet qartë veprimtaria e IHMK-së. Projektligji do të avansojë sistemin e monitorimit të elementeve dhe dukurive meteorologjike, hidrologjike dhe cilësisë së ajrit, ujit dhe dheut si dhe sistemin e paralajmërimit të fatkeqësive natyrore siç janë: vërshimet, thatësitrat, breshëri, ortekët etj. Po ashtu do të definojë qartë mënyrat e ofrimit të shërbimit më efikas ndaj palëve të interesit dhe personave fizikë dhe juridikë.

Përmbledhja e opsioneve

<i>Përmbledhja e opsioneve</i>			
<i>Karakteristikat kryesore</i>	<i>Opsioni 1 Status-quo</i>	<i>Opsioni 2 plotësim ndryshimi i kornizës aktuale</i>	<i>Opsioni 3 Hartimi i Ligjit të ri</i>
<i>Karakteristikat kryesore të opsionit</i>	Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale	Plotësimi i pjesërishëm i legjislacionit	Hartimi i ligjit të ri për Veprimtaritë Hidrometeorologjike në përputhshmëri me standardet e OBM-së dhe legjislacionit të BE-së
<i>Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar</i>	Përfshihen të gjitha komunitetet	Përfshihen të gjitha komunitetet	Përfshihen të gjitha komunitetet
<i>Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët</i>	MMPH Institucionet relevante të niveli qendror dhe lokal, sektori privat dhe qytetarët	MMPH Institucionet relevante të niveli qendror dhe lokal, sektori privat dhe qytetarët	MMPH Institucionet relevante të niveli qendror dhe lokal, sektori privat dhe qytetarët
<i>Administrimi ose</i>	MMPH	MMPH	MMPH

<i>zbatimi i programit ose shërbimit</i>			
<i>Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet</i>	Baza e Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologji kështë nxjerrur nga rregulloret e OBM	Hartimin e Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike	Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike
<i>Stimulimet ose mos- stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat</i>	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
<i>Fushatat e edukimit dhe komunikimit</i>	Takime me pale të interesit për hartimin e këtij ligji.	Parashihet fushatë promovuese	Parashihet fushatë promovuese
<i>Udhëzimet</i>	Në harmoni me legjislacionin e BE-së	Në harmoni me legjislacionin e BE-së	Në harmoni me legjislacionin e BE-së
<i>Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni</i>	Është në fuqi	Deri në fund të vitit 2014	Deri në fund të vitit 2014

Analiza e opsioneve

Ky veprim legjislativ do të ishte në vijë të plotë me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave për administrimin e Veprimtarisë Hidrometeorologjike që do të jetë në pajtim me standardet e OBM dhe atyre të BE-së dhe vendeve të rajonit.

Përfitimet

Me hartimin e këtij Ligji krijohen mekanizma dhe instrumente që do të lehtësojnë zbatimin e tij dhe të kontribuojnë në administrimin më të mirë të veprimtarive hidrometeorologjike me:

Avansimin e sitemit monitorues të dukurive dhe elementeve hidro-meteorologjike: ku përfshinë mbledhjen dhe analizën e të dhënave, për të kryer procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të situatës hidrologjike dhe meteorologjike si dhe situatën mbi cilësisë e ajrit, ujit dhe dheut. Ministria si organ është përgjegjës për hartimin e këtij ligji duke u siguruar se të gjitha organet tjera, agjencioni dhe komuniteti i gjerë janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të tyre për arritjen e një administrimi më të

mirë të veprimtarisë hidrologjike dhe meteorologjike.

Ngritjen e sistemit të paralajmerimit të hershem të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore: Shmang dëmet në njerëz dhe në të mira materiale, kontribuon në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së jetës së njeriut përmes integritit të udhëzimeve (rregullores për procedura standarde operative) për mënyren e paralajmërimit dhe informimit të institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal.

Hartimi i procedurave standarde operative për komunikim ndërinstitucional: luan rol të rëndësishëm në implementimin e këtij ligji, pasi që kjo e lehtëson mënyren e komunikimit ndërinstitucional dhe rrit efikasitetin në informimin e institucioneve për dukuritë hidrometeorologjike dhe cilësinë e ajrit, ujit dhe dheut. Në këtë rastë planet operative të aktiviteteve ndaj fatkeqësive natyrore do të jenë më efikase, në të njëjtën kohë edhe dëmet materiale dhe në njerëz do të zvogëlohen.

Zbatimi i këtyre veprimeve do të ndihmojë në:

- Zvogëlimin e dëmeve në njerëz, prona dhe në mjedis,
- Zbatimi i planeve dhe aktiviteteve në mënyrë efektive dhe me kohë
- Siguron bashkëpunim të të gjitha komuniteteve për të kuptuar rëndësinë dhe inkurajimin i tyre për të kontribuar në avansimin e administrimit më të mirë të dukurive hidrometeorologjike.

Analiza e kostos

Miratimi i Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike nuk ka kosto shtesë, përkatësisht nuk ka implikime financiare.

Tabelat ne excel te bashkangjitura përmbajnë koston vjetore të shërbimeve, për zbatimin e ligjit

Tabela më poshtë përmban një analizë të kostos së të tri opsioneve

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatoreve	0	0	0	0
Opsioni 2				

Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0

Ndikimi

Ndikimi ekonomik dhe social- Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, sukcesi afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe social do të varet nga qëndrueshmëria e politikave të caktuara, në fushën e industrisë, energjisë, minierave, transportit, bujqësisë etj. Por secila nga këto politika, pa marrë parasysh nëse shikohen ndaras ose bashkërisht me të tjerat, është e varur nga ndikimi i kushteve meteorologjike dhe hidrologjike të një vendi.

Arritja e baraspeshës së dëshiruar mes aktivitetit njerëzor dhe dukurive hidrometeorologjike, kërkon analizë të saktë të ndikimit të veprimtarive hidrometeorologjike në zhvillimin e ekonomisë së një vendi.

Konsultimi

Për hartimin e këtij ligji janë konsultuar departamentet dhe Agjensionet brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe është arritur përfundimi se duhet të bëhet hartimi i Ligjit për Veprimtaritë Hidrometeorologjike.

Poashtu nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji ka rrjedhë gjatë konsultimit me institucionet tjera ndërministrore dhe gjatë konsultimeve të standardeve të OBM dhe legjislacionit të R. Kosovës.

Procesi i konsultimeve është inicuar duke bërë prezantimin e draft-dokumentit në ueb faqen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe shpërndarjen e tij nëpër institucione, përfaqësuesit e të cilëve janë pjesë e hartimit të dokumentit, duke përfshirë edhe organizimin e debatit publik. Dokumenti është kompletuar, pas shqyrtimit të komenteve të dhëna nga palët e interesuara siç janë:

Sekretariati Koordinues i Qeverisë
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Departamentet e MMPH
Agjensioni për menagjim të emergjencave
Drejtoria e Mjedisit në Komunën e Prishtinës.

Gjatë konsultimeve është konsideruar se nxerrja e ligjit të ri është nevojë e qëlluar e cila do të jetë në pajtim me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave për mbrotjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, nga dukuritë e ndryshme hidrometeorologjike dhe nga dryshimet klimatike.

Bazuar në këtë koncept-dokument, pas miratimit me vendim nga Qeveria, MMPH do të kryesojë grupin punues në të cilin do të marrin pjesë edhe përfaqesues nga Ministrinë tjera relevante, konform Rregullorës së Punës së Qeverisë.

Rekomandimet

Masat dhe obligimet e përcaktuara në Ligjin e ri për Veprimtarinë Hidrometeorologjike, paraqesin obligim për të gjithë sektorët e komuniteteve dhe janë përgjegjëse për të realizuar veprimet për arritjen e objektivave për cilësinë e ajrit.

Organet e veçanta të Ministrisë kryejnë detyrat e veçanta, të përcaktuara me këtë ligj.

Republika e Kosovës është duke u angazhuar fuqimisht në arritjen e kushteve për procesin e negociatave për pranimin dhe antarësimin e plotë në BE, ku si sfida e veçantë është harmonizimi dhe zbatimi i legjislacionit për fushën e hidrologjisë dhe meteorologjisë.

Kjo kërkon ndryshime sistematike institucionale, organizative dhe investime në teknikat më të mira në dispozicion, në mënyrë që të përmbushen objektivat e vendosura në lidhje me parandalimin dhe paralajmërimin e rreziqeve nga dukuritë hidrologjike dhe meteorologjike.

Me ndryshimet që do të bëhen në këtë ligj, do të përfitohet në;

- zbatimin më të mirë të legjislacionit mjedisor dhe ligjeve që ndërlidhen me veprimtarinë hidrometeorologjike;
- zvoglimin e dëmeve ekonomike, sociale dhe mjedisore nga fatkeqësitë natyrore;
- përdorimin efektiv të resurseve natyrore dhe
- ngritjen e cilësisë së planifikimit urban dhe industrial.

Para se të dërgohet në Qeveri për miratim drafti i parë i projektligjit do të dërgohet në konsultime paraprake dhe do të publikohet në ueb-faqen e MMPH-së, për qëllime të konsultimit të akterëve të tjerë të interesuar.